

Nr. 1545 Rep. Nr. 278 Kol.

Elbasan, me 15.07.2005

KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Ne Elbasan, sot ne date 15.07.2005 (pesembedhete korrik dymijepese) perpara meje noteres Enkelejda Marinaj, me seli ne Lagjen "5 Maj" te qytetit te Elbasanit, perpara Gjykates se Rrethit Gjyqsor Elbasan, u paraqiten kontraktuesit si pale:

Me cilesine e shitesit : **ARIF TERZIU**, i biri i Abdylit dhe i Fatimese, dtl.03.02.1932, lindur ne Peshkopi e banues ne Elbasan, Lagja "e Re", mbajtes i pasaportes nr.0510360, leshuar me 05.11.1996.

Me cilesine e bleresit: **ARBEN TERZIU**, i biri i Arifit dhe i Sanijes, dtl.06.07.1963, lindur ne Elbasan me banim ne Austri, mbajtes i pasaportes austriake nr.C0010974 3, leshuar me 12.09.1997.

Qe te dy madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje, me pembajtje si me poshte vijon:

Objekti i kontrates : Shitblerje kuotash te shoqerise "TERZIU" shpk.

Kushtet e kontrates:

Shoqeria "TERZIU" shpk, eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr.6100, date 05.09.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane, me ortak te vetem themelues z. Arif Terziu, me kapital themeltar 100% kontribut i ortakut te vetem themelues, me seli ne Lagjen "e Re" Elbasan, me afat veprimtarie 15 vjet, me administrator te shoqerise z.Arif Terziu, dhe objekt veprimtarie, sipas akt-themelimit dhe statutit te shoqerise.

Me vendimin nr.1, date 15.07.2005 te ortakut te vetem, eshte vendosur largimi nga shoqeria si ortak i z.Arif Terziu, duke u kaluar ne favor te ortakut te ri z. Arben Terziu te gjitha kuotat prej 100% te kapitalit themeltar.
Nepermjet kesaj kontrate, realizohet shitja nga ana e shitesit Arif Terziu dhe bletja nga ana e bleresit Arben Terziu e teresise prej 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

Shitesi Arif Terziu deklaroi se 100 % te kuotave te kapitalit themeltar, ia shet bleresit Arben Terziu.

Bleresi Arben Terziu, deklaroi se eshte dakort te bleje nga shitesi 100% te kuotave te kapitalit themeltar.

Palet deklarojne se jane shlyer totalisht me njera tjetren jashte kesaj zyre noterie.


Me lidhjen e kesaj kontrate, shitesi zhvishet nga pronesia mbi te gjitha kuotat e kapitalit themeltar, pronesi kjo qe i kalon bleresit, i cili behet ortak i vetem i shoqerise, duke zoteruar ne kete menyre 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Per sa me siper, redaktohet ky akt ne pese origjinale te njejte, ne perputhje te plote me vullnetin e porositesve te tij, lexohet prej tyre dhe nenshkruhet pa verejtje, nga vete ata ne pranine time noteres.

Une noterja, duke patur parasysh edhe kerkesat e nenit 705 e vijues te K.Civil, Ligjit 7638, date 19.11.1992, Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 si dhe Ligjit 7829, date 01.06.1994, "Per noterine", e vertetoj.

SHITESI

ARIF TERZIU



BLERESI

ARBEN TERZIU



NOTERE

Erkelejda Marinaj

